

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance Arhiva - Archive	
Mbledhje Org. Org. 2. / Sub- Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.
06	1171
Nr. i kopjeve No. copies	Data e dërgimit Date
4	08/08/2019
Hyrësja PIRASHITË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance
 Departamenti i Buxhetit / Departamentat Budzeta / Budget Department

DATË/A:	07.08.2019
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e komunave, Drejtorët e drejtorive komunale, Zyrtarët kryesor financiar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm, MF
NGA/OD/FROM:	<i>Kër</i> Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, MF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2020/02 për Komuna

Të nderuar Kryetarë të Komunave,

Po ju dërgojmë Qarkoren Buxhetore 2020/02 për komuna, përmes së cilës ju njoftojmë mbi strukturën e shpenzimeve për vitin 2020 dhe parashikimet për vitet 2021-2022, sipas kufijve të financimit komunal të dhënë me Qarkoren Buxhetore 2020/01 të datës 15 maj 2019, dhe në pajtim me rregullat e aplikueshme fiskale.

Kjo qarkore është nxjerrë në përputhje me kompetencat ligjore të Ministrisë së Financave, sipas nenit 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Udhëzimet e dhëna në këtë qarkore mbi strukturën e shpenzimeve bazohen në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2020-2022 (KASH), ku përcaktohet niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve afat-mesme për buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Ju lutem të keni parasysh udhëzimet në këtë qarkore në përgatitjen e propozim-buxhetit për komunën tuaj për vitin 2020 dhe parashikimet afatmesme 2021-2022. Siç e dini, Ministria e Financave ka organizuar forume dhe takime konsultuese gjatë muajit korrik 2019 me të gjitha komunat për zhvillimin e procesit buxhetor komunal.

Për informata shtesë apo ndihmesë lidhur me cilindo element të kësaj qarkore, ju lutem kontaktoni analistët e buxhetit në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financave.

Me respekt!

Salvador Elmazi,
Drejtor i Departamentit të Buxhetit, MF

I. Parimet bazë për përgatitjen e buxhetit komunal 2020-2022

Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të ruaj stabilitetin makro-fiskal, dhe brenda një kornize të qëndrueshme buxhetore të ofrojë mundësinë e financimit të prioriteteve strategjike.

Bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. Po ashtu, komunat janë të obliguara që nga granti i përgjithshëm të ndihmojnë financimin e shpenzimeve për sektorin e shërbimeve sociale.

Në këtë qarkore janë marrë parasysh prioritetet e Qeverisë, duke ruajtur kështu raportin në mes të shpenzimeve rrjedhëse dhe shpenzimeve kapitale.

Shpenzimet rrjedhëse: Krahasuar me vitin paraprak, ka rritje të theksuar te kategoritë e shpenzimeve rrjedhëse.

Punësimi: Nuk do të ketë rritje të punësimit krahasuar me vitin paraprak, përveç rritjes së stafit me vendim të Komisionit të Granteve (stafit për teatro dhe shërbimet rezidenciale).

Në kategorinë e shpenzimeve **paga dhe mëditje** kalkulimi është bërë duke u bazuar nën supozimin e koeficienteve të rinj që mundë të përcaktohen me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik (parashikimet e hershme nga MAP) si dhe financimin e stafit për teatrot dhe shërbimet rezidenciale.

Kjo kategori mund të ketë ndryshime për arsye se ende nuk janë kompletuar aktet nën ligjore që e plotësojnë këtë Ligj, dhe në rast të paraqitjes së ndryshimeve të do të njoftoheni me kohë.

Në kategorinë e shpenzimeve **mallra dhe shërbime** rritja është dedikuar kryesisht për:

- Adresimin e keq-klasifikimeve ekonomike të mjeteve në kuadër të shpenzimeve kapitale, (mjete këto që sipas natyrës i përkasin kategorisë së shpenzimeve mallra dhe shërbime),
- Mbulimin e nevojave të financimit për menaxhimin e mbeturinave, dhe
- Mbështetjes buxhetore për arsimin para universitar dhe shëndetësinë primare.

Në kategorinë e **shpenzimeve komunale** rritja është dedikuar për të mbuluar obligimet komunale të cilat janë në rritje të vazhdueshme.

Po ashtu edhe në kategorinë e shpenzimeve **subvencione dhe transfere** ka rritje krahasuar me vitin paraprak kryesisht për shkak të keq-klasifikimeve ekonomike të mjeteve në kuadër të shpenzimeve kapitale dhe financimit për teatrot. Planifikimi në kategorinë subvencione dhe transfere duhet të bëhet nga të hyrat vetanake komunale.

Shpenzimet kapitale: Sa i përket shpenzimeve kapitale, me anë të kësaj qarkoreje ofrohet hapësirë për një rritje më të theksuar të investimeve publike lokale si rezultat i rritjes së financimit total komunal për vitin 2020-2022.

Gjatë procesit të planifikimit të investimeve kapitale, në pajtim me detyrimet ligjore, secila komunë duhet fillimisht të planifikoj burime për financimin e plotë të projekteve që janë në vijim e sipër.

Komunat mund të planifikojnë projekte të reja nëse buxheti i planifikuar ofron hapësirë shtesë mbi obligimet për implementimin e projekteve ekzistuese, përfshirë edhe projektet me bashkëfinancim me ministritë e linjës apo me donatorët potencial.

Gjatë planifikimit të projekteve kapitale duhet të keni parasysh strukturën ekzistuese të planit kontabël, me qëllim të zbatimit adekuat të klasifikimeve ekonomike të cilat verifikohen përmes procesit të auditimit.

Udhëzime rreth planifikimit të buxhetit:

Për të ruajtur disiplinën fiskale dhe në bazë të detyrimeve ekzistuese ligjore, organizatave buxhetore nuk ju lejohet të rrisin koeficientet e pagave dhe të shtojnë numrin e punëtorëve përtej kufizimeve të dhëna me ligjin e buxhetit. Punësimi i stafit të ri duhet të bëhet në përputhje me masën monetare në dispozicion për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje për vitin 2020 dhe parashikimet 2021-2022. Duhet gjithashtu të respektohen dispozitat ligjore me rastin e pagesës për punën pas orarit të rregullt. Çdo mosrespektim i këtyre kufizimeve nga organizata buxhetore është hyrje në obligim pa mbulesë, dhe rrjedhimisht paraqet shkelje të LMFP-së dhe Ligjit vjetor të buxhetit.

Shpenzimet rezidenciale janë të shpërndara sipas kategorive të shpenzimeve përkatëse brenda strukturës së përgjithshme të shpenzimeve të komunave. Për të siguruar ofrimin e shërbimeve rezidenciale, komunat obligohen të zbatojnë udhëzimet e MPMS-së për shpërndarjen e mjeteve buxhetore nëpër kategori të ndryshme të shpenzimeve në nën programin e Shërbimeve Rezidenciale brenda kufijve të financimit për Shërbimet Rezidenciale të cilat janë aprovuar nga Komisioni i Granteve dhe pasqyruar në Qarkoren Buxhetore 2020/01.

Mjetet për financimin e teatrove janë të shpërndara sipas kategorive të shpenzimeve brenda strukturës së përgjithshme të shpenzimeve në komuna sipas aprovimit nga Komisioni i Granteve. Në Sistemet elektronike SIMFK dhe BDMS do të hapet nën-programi i ri për teatrot.

2. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitet 2020-2022 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të lëshuar me këtë qarkore. Tabela që paraqet strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2020 dhe vlerësimet për vitin 2021-2022 për komuna është dhënë në Aneks 1.

3. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ)

Komunat duhet të adresojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor sipas udhëzimeve të dhëna me Qarkoren Buxhetore 2020/01.

4. Dorëzimi i propozim-buxhetit komunal për vitet 2020-2022

Pas aprovimit të propozim-buxhetit për vitin 2020-2022 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave deri me datë 30 shtator 2019. Propozim buxheti i aprovuar duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- ✓ Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
- ✓ Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2020-2022, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.

- ✓ Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2020-2022 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2020 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2021-2022 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 3.1.B - plani i ndarjeve buxhetore sipas klauzolës së investimeve,
 - Tabela 3.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve,
 - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjijnor.

